FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.134 11 shtator 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.849, datë 5.8.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, me statusin e zonës së lirë, të një territori në Vlorë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	6247
Vendim i KM nr.883, datë 13.5.2009	Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale	6247
Udhëzim i MASH nr.20, datë 29.7.2009	Për disa ndryshime në shtojcën 1 të udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 "Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse".....	6256
Udhëzim i MASH nr.21, datë 30.7.2009	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë.....	6257
Vendim i ERE nr.58, datë 7.8.2009	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë BALKAN GREEN ENERGY sh.p.k. me seri PV03K, nr.3, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003.....	6259
Vendim i ERE nr.59, datë 19.8.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin ne aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "TEODORI 2003" sh.p.k.....	6260

Vendim i ERE nr.60, datë 19.8.2009	Për kualifikimin e impianteve prodhuese (parku eolik Maskuri) të shoqërisë "RUNNING ENERGY", si burime të rinovueshme energjie.....	6261
Vendim i ERE nr.61, datë 19.8.2009	Për licencimin e shoqërisë "PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	6262
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Hajdar Hasan Kasa.....	6263

VENDIM
Nr.849, datë 5.8.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE, ME STATUSIN E ZONËS SË LIRË, TË NJË TERRITORI NË VLORË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", dhe të neneve 4, pika 1, shkronja "g", 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, me statusin e zonës së lirë, të një territori në Vlorë, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 8 për qind të pikëve për rezultatin ekonomik, financiar, teknik dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse, konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Zumax AG".
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.883, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 202, 25, 28, 33, 41, 44, 46, 76, 77, 79, 80, 82, 109, 137, 149, 172, 194, 198 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me patentat e shpikjeve, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me modelet e përdorimit, janë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur disenjot industriale, janë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me markat tregtare dhe të shërbimit, janë sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me treguesit gjeografikë, janë sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPM, lidhur me qarqet e integruara, janë sipas lidhjes nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Tarifat për shërbime të tjera të kryera pranë DPPM janë sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.379, datë 15.08.1994 "Për tarifat e zyrës së patentave për objektet e pronësisë industriale" me ndryshimet e mëvonshme, shfuqizohet.

11. Të ardhura që Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave krijon në përputhje me këto tarifa, përdoren në masën 10% për nevojat e veta sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

I. TARIFAT PËR PATENTAT E SHPIKJEVE

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
1.1	Tarifë për depozitim aplikimi për patentë	7,000
1.2	Tarifë për depozitimin e aplikimeve të PCT	7,000
1.3	Tarifë për çdo pretendim mbi pretendimin e 10-të të patentës	500
1.4	Tarifë për depozitimin e çdo aplikimi të ndarë të patentës	5,000
1.5	Tarifë për publikimin e patentës europiane dhe të amendamenteve në patentë	1,000
1.6	Tarifë për publikim të parakohshëm të patentës	2,000
1.7	Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave	7,000
1.8	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
1.9	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në aplikimin për patentë	2,000
1.10	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në patentë	2,000
1.11	Tarifë për lëshimin e patentës	6,000
1.12	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit të dhënies së patentës	7,000
1.13	Tarifë për apelim në Bordin e Apelimit	7,000
1.14	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi aplikimin për patentë ose patentën	4,000
1.15	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të patentës	3,000
1.16	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të patentës	3,000
1.17	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licensës mbi patentën	4,000
1.18	Tarifë për dorëheqjen nga patenta	1,000
1.19	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një patentë	500
1.20	Tarifë për kryerjen e hetimit mbi një patentë	500
1.21	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1,000
1.22	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për një patentë	3,000
1.23	Tarifë për inspektim dosje të patentës	1,000
1.24	Tarifë ripërtëritje viti I	4,000
1.25	Tarifë ripërtëritje viti II	5,000
1.26	Tarifë ripërtëritje viti III	6,000
1.27	Tarifë ripërtëritje viti IV	7,000
1.28	Tarifë ripërtëritje viti V	8,000
1.29	Tarifë ripërtëritje viti VI	10,000
1.30	Tarifë ripërtëritje viti VII	12,000
1.31	Tarifë ripërtëritje viti VIII	14,000
1.32	Tarifë ripërtëritje viti IX	16,000
1.33	Tarifë ripërtëritje viti X	20,000
1.34	Tarifë ripërtëritje viti i XI	22,000
1.35	Tarifë ripërtëritje viti i XII	25,000
1.36	Tarifë ripërtëritje viti i XIII	27,000
1.37	Tarifë ripërtëritje viti i XIV	30,000
1.38	Tarifë ripërtëritje viti i XV	32,000
1.39	Tarifë ripërtëritje viti i XVI	35,000
1.40	Tarifë ripërtëritje viti i XVII	37,000
1.41	Tarifë ripërtëritje viti i XVIII	40,000
1.42	Tarifë ripërtëritje viti i XIX	45,000
1.43	Tarifë ripërtëritje viti i XX	50,000
1.44	Tarifë për transferimin e aplikimeve të bëra në bazë të PCT	3,000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (Nr.rendor 1.24-1.43) do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës ka deklaruar me shkrim gatishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49 pika 1 e ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale".

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (Nr.rendor 1.24-1.43) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati, në përputhje me parashikimin e nenit 41 pika 3 e ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

Lidhja nr.2

II. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR CERTIFIKATAT E MBROJTJES SHTESË PËR PRODUKTET MJEKËSORE DHE PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Nr.	**Llojet e Tarifave**	**Vlera në lekë**
2.1	Tarifë për depozitim aplikimi për certifikatë të mbrojtjes shtesë	20,000
2.2	Tarifë ripërtëritje viti XXI	100,000
2.3	Tarifë ripërtëritje viti XXII	120,000
2.4	Tarifë ripërtëritje viti XXIII	150,000
2.5	Tarifë ripërtëritje viti XXIV	200,000
2.6	Tarifë ripërtëritje viti XXV	250,000
2.7	Tarifë për depozitimin e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së certifikatës së mbrojtjes shtesë	8,000
2.8	Tarifë për apelim në ëin e apelimit	8,000
2.9	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga certifikata e mbrojtjes shtesë	1,000
2.10	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një certifikatë të mbrojtjes shtesë	500
2.11	Tarifë për kryerjen e hetimeve për një certifikatë të mbrojtjes shtesë	500
2.12	Tarifë për lëshim dublikate	1,000
2.13	Tarifë për inspektim dosje	1,000

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e certifikatave të mbrojtjes shtesë (Nr.rendor 2.2-2.6) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati.

III. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR MODELET E PËRDORIMIT

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
3.1	Tarifë për depozitim aplikimi për model përdorimi	6,000
3.2	Tarifë për kthimin e kërkesës për patentë shpikje në kërkesë për model përdorimi	3,500
3.3	Tarifa për çdo pretendim mbi pretendimin e 10-të	500
3.4	Tarifë për depozitimin e çdo aplikimi të ndarë	4,000
3.5	Tarifë për publikim të parakohshëm të modelit të përdorimit	2,000
3.6	Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave	7,000
3.7	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
3.8	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në aplikimet për modele përdorimit	2,000
3.9	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në patentat për modelet e përdorimit	2,000
3.10	Tarifë për lëshimin e patentës për modelet e përdorimit	6,000
3.11	Tarifë për apelimet në bordin e apelimit lidhur me modelet e përdorimit	10,000
3.12	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit të dhënies së patentës për modelet e përdorimit	7,000
3.13	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licensës për modelet e përdorimit	4,000
3.14	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit	3,000
3.15	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit	3,000
3.16	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi një model përdorimi	4,000
3.17	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga një model përdorimi	1,000
3.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një model përdorimi	500
3.19	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1,000
3.20	Tarifë për kryerjen e hetimit për një model përdorimi	500
3.21	Tarifë për inspektim dosje për modelet e përdorimit	1,000
3.22	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për modelet e përdorimit	3,000
3.23	Tarifë ripërtëritje viti I	4,000
3.24	Tarifë ripërtëritje viti II	5,000
3.25	Tarifë ripërtëritje viti III	6,000
3.26	Tarifë ripërtëritje viti IV	7,000
3.27	Tarifë ripërtëritje viti V	8,000
3.28	Tarifë ripërtëritje viti VI	9,000
3.29	Tarifë ripërtëritje viti VII	10,000
3.30	Tarifë ripërtëritje viti VIII	12,000
3.31	Tarifë ripërtëritje viti IX	15,000
3.32	Tarifë ripërtëritje viti X	20,000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit (Nr.rendor 3.23-3.32) do të reduktohen ne masën 50% të vlerës përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastin kur pronari i modelit të përdorimit ka deklaruar me shkrim gadishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49 pika 1 e ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit (Nr.rendor 3.23-3.32) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati, në përputhje me parashikimin e nenit 41 pika 3 e ligjit nr.9947 datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

Lidhja nr.4

IV. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR DISENJOT INDUSTRIALE

Nr.	**Llojet e Tarifave**	**Vlera në lekë**
4.1	Tarifë për depozitim aplikimi për disenjo industriale	4,000
4.2	Tarifë për regjistrimin e disenjos industriale	6,000
4.3	Tarifë aplikimi për cdo dizenjo shtesë (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.4	Tarifë për depozitimin e çdo kërkesë të ndarë nga kërkesa fillestare (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.5	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit të disenjos industriale pas publikimit	7,000
4.6	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të dizenjos industriale	3,000
4.7	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të dizenjos industriale	3,000
4.8	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi një disenjo industriale	4,000
4.9	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licencës të dizenjos industriale	4,000
4.10	Tarifë për ripërtëritjen e disenjos industriale	6,000
4.11	Tarifë ripërtëritje për çdo disenjo shtesë (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.12	Tarifë shtesë për ripërtëritjen e disenjos industriale pas mbarimit të afatit të mbrojtjes, por brenda një periudhe 6 mujore nga përfundimi i tij	3,000
4.13	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga disenjo industriale	1,000
4.14	Tarifë për tranferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të disenjos	4,000
4.15	Tarifë për tranferimin e kundërshtimit të regjistrimit ndërkombëtar të disenjos	4,000
4.16	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj një disenjo industriale të publikuar	7,000
4.17	Tarifë për apelimin e vendimit të refuzimit të disenjos	7,000
4.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një disenjo industriale	500
4.19	Tarifë për kryerjen e hetimit për një disenjo industriale	500
4.20	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1,000
4.21	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për disenjot industriale	3,000
4.22	Tarifë për inspektim dosje	1,000
4.23	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
4.24	Tarifë për ekzaminimin jashtë radhe të aplikimit	2,000
4.25	Tarifë për shtyrjen e afatit të publikimit tek disenjot	2,000

Lidhja nr.5

V. TABELA E TARIFAVE PËR MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
5.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për markë individuale	5,000
5.2	Tarifë aplikimi për çdo klasë shtesë për markat individuale	2,500
5.3	Tarifë për regjistrimin e markës individuale	6,500
5.4	Tarifë për depozitimin e aplikimit për markë kolektive	6,500
5.5	Tarifë aplikimi për çdo klasë shtesë për markat kolektive	3,000
5.6	Tarifë për regjistrimin e markës kolektive	6,500
5.7	Tarifë për kufizimin e listës së mallrave	2,500
5.8	Tarifë për depozitimin e çdo kërkese të ndarë nga aplikimi fillestar	2,500
5.9	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj markës së publikuar	7,000
5.10	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të markës	2,500
5.11	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të markës	2,500
5.12	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi markën	4,000
5.13	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licensës mbi markën	4,000
5.14	Tarifë për ripërtëritjen e markës	8,000
5.15	Tarifa e ripërtëritjes për cdo klasë shtesë të markës	4,000
5.16	Tarifë shtese për ripërtëritjen e markës pas mbarimit të afatit të mbrojtjes, por brenda një periudhe 6 mujore nga përfundimi i tij	2,000
5.17	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga marka	1,000
5.18	Tarifë për transferimin e aplikimit për regjistrimin ndërkombëtar të markës (Marrëveshja e Madridit)	4,000
5.19	Tarifë për transferimin e aplikimit për shtrirjen e mëvonshme territoriale të mbrojtjes së markës ndërkombëtare (Marrëveshja e Madridit)	2,000
5.20	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar të markës (Marrëveshja e Madridit)	5,000
5.21	Tarifë për apelimin e vendimit të refuzimit të markës	7,000
5.22	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
5.23	Tarifë për ekzaminimin jashtë radhe të aplikimit	2,000

Lidhja nr.6

VI. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR TREGUESIT GJEOGRAFIKË

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
6.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik	5,000
6.2	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj një treguesi gjeografik të publikuar	7,000
6.3	Tarifë për lëshimin e certifikatës së regjistrimit të treguesit gjeografik	6,000
6.4	Tarifë për apelimin e vendimit të refuzimit të treguesit gjeografik	7,000
6.5	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të treguesit gjeografik	3,000
6.6	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës aë aplikantit/pronarit të treguesit gjeografik	3,000
6.7	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga treguesi gjeografik	1,000
6.8	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistri për treguesit gjeografik	500
6.9	Tarifë për kryerjen e hetimit për treguesit gjeografik	500
6.10	Tarifë për lëshimin e dublikatave për treguesit gjeografik	1,000
6.11	Tarifë për inspektim dosje	1,000
6.12	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
6.13	Tarifë për ekzaminimin jashtë radhe të aplikimit	2,000

Lidhja nr.7

VII. TABELA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET LIDHUR ME TOPOGRAFITË E QARQEVE TË INTEGRUARA

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
7.1	Tarifë depozitimi të aplikimit për topografitë e qarqeve të integruar	6,000
7.2	Tarifë regjistrimi për topografitë e qarqeve të integruar	6,000
7.3	Tarifë ndryshimi emri dhe /ose adrese për topografitë e qarqeve të integruar	3,000
7.4	Tarifë transferimi pronësie për topografitë e qarqeve të integruar	4,000
7.5	Tarifë regjistrimi të kontratës së licencës për topografitë e qarqeve të integruar	4,000
7.6	Tarifë për apelimet pranë bordit të apelimit	7,000
7.7	Tarifë për kundërshtimin e aplikimit për topografitë e qarqeve të integruara	7,000
7.8	Tarifë për dorëheqje nga mbrojtja e topografive të qarqeve të integruara	1,000
7.9	Tarifë për ekstrakt regjistri për topografitë e qarqeve të integruar	500
7.10	Tarifë për hetim lidhur me topografitë e qarqeve të integruara të regjistruara në regjistrin përkatës të DPPM	500
7.11	Tarifë për lëshim dublikate	1,000
7.12	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për topografitë e qarqeve të integruara	3,000
7.13	Tarife per inspektim dosje	1,000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e topografive të qarqeve të integruara janë të njëjta me ato të patentave të parashikuara në lidhjen dhe do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës ka deklaruar me shkrim gatdishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49 pika 1 e ligjit 9947 datë 7/7/2008 "Për pronësinë industriale.

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e topografisë së qarqeve të integruara do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati. Kjo tarifë ripëtëritje konsiderohet gjobë (penalitet) për mospagim në kohë.

Lidhja nr.8

VIII. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË TJERA

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
8.1	Tarifë për pjesemarrjen në testim të përfaqesuesve të autorizuar	1,000
8.2	Tarifë për rregjistrimin e përfaqesuesve të autorizuar	5,000

UDHËZIM
Nr.20, datë 29.7.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË SHTOJCËN 1 TË UDHËZIMIT NR.5, DATË 22.1.2008 "PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE TË NEVOJSHME PËR HAPJEN, MBYLLJEN DHE RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS, SI DHE TË ELEMENTEVE BAZË, SIPAS TË CILAVE INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DUHET TË PËRGATISIN RREGULLOREN PËRKATËSE

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e shtojcës 1 të udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 "Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse", ndryshon si më poshtë:

"3. Elemente të përgjithshme të programit të studimit të doktoratës

Viti I
Viti II
Viti III

Kur, për raste të veçanta, kohëzgjatja normale e programit të doktoratës, në formën me kohë të plotë, nevojitet të jetë më shumë se tre vjet, të specifikohen elementet e përgjithshme të programit të studimit dhe për vitet e tjera.".

2. Pika 4 e shtojcës 1, ndryshon si më poshtë:

"4. Plani i detajuar mësimor për thellimin teorik

Të jepet plani mësimor duke detajuar shpërndarjen në vite dhe semestra të disiplinave, të seminareve dhe çdo aktiviteti tjetër formues, shoqëruar me numrin e krediteve dhe orëve përkatëse, si dhe kërkesat për frekuentimin dhe verifikim të dijeve.

Emërtimi i aktivitetit	Kreditë	Orë mësimore	Viti/semestri	Frekuentim	Mënyra e verifikimit të dijeve	Personi përgjegjës
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

UDHËZIM
Nr.21, datë 30.7.2009

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, pika 1.3, e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të doktoratës duke iu referuar numrit të kuotave të dhëna për programin përkatës.

2. Për t'u pranuar në një program studimi të doktoratës, kandidati duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, DND, një diplomë të integruar të nivelit të dytë, DIND, dhe çdo diplomë tjetër të vlerësuar të njëvlefshme me to, në fushën e programit të doktoratës apo në një fushë të përafërt të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të doktoratës.

3. Gjithashtu kanë të drejtë të pranohen në programe të doktoratës edhe ata kandidatë që zotërojnë një diplomë apo certifikatë të kualifikimeve të ciklit të tretë të studimeve.

4. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve, pasi marrin paraprakisht mendimin e këshillit të profesorëve dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.

5. Njësitë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë që janë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit të doktoratës organizojnë edhe procesin e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në çdo program përkatës studimi doktorate. Procesi monitorohet nga rektorati dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Me caktimin e kuotave nga Këshilli i Ministrave për një program studimi doktorate, institucioni i arsimit të lartë përgjegjës shpall menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për një periudhë 2-javore pasi merr paraprakisht mendimin e njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin e këtij programi studimi.

7. Aplikimi për regjistrim në programet e doktoratës bëhet pranë sekretarive të njësive kryesore përgjegjëse për organizimin e programit përkatës së doktoratës.

8. Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në një program studimi doktorate me dosje individuale, e cila duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesa e kandidatit drejtuar këshillit të profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e doktoratës.

b) CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla.

c) Kopje të noterizuar të diplomës së nivelit të dytë (DND) apo të diplomës së integruar të nivelit të dytë, apo të një diplome tjetër studimi, ekuivalente me to, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga MASH-i.

d) Kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose certifikate ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandiati disponon një të tillë.

e) Vërtetim për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit, së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment, nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë.

f) Fotokopje të noterizuar të kartës së indentitetit/pasaportës.

g) Dy fotografi.

h) Dy rekomandime nga persona me titull akademik.

i) Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni.

j) Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje të noterizuar).

k) Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar.

l) Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim prej 2000 lekë.

9. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga këshilli i profesorëve të njësisë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë përgjegjëse për organizimin e programit përkatës të doktoratës nëpërmjet një konkurrimi me dosje, ku kandidatët nga personeli akademik të punësuar me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë kanë përparësi.

10. Këshilli i profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e doktoratës ngre komisione *ad-hoc* me anëtarë të tij sipas fushës përkatëse të çdo programi doktorate për përzgjedhjen e kandidatëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht më parë. Kryetari i çdo komsioni të tillë është dekani.

11. Një javë pas mbylljes së aplikimeve komisionet *ad-hoc* paraqesin listat e kandidatëve fitues në këshillin e profesorëve të njësisë kryesore. Listat e kandidatëve fitues miratohen nga këshilli i profesorëve dhe shpallen nga dekani jo më vonë se 2 javë nga mbyllja e aplikimeve.

12. Dekani i njësisë kryesore përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo fitues. Këshilli i profesorëve shqyrton çdo ankimim dhe shprehet me vendim. Vendimi i tij është përfundimtar.

13. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin përkatës të doktoratës për një periudhë njëjavore të përcaktuar nga dekani i njësisë kryesore.

14. Kandidatët fitues duhet të paguajnë një tarifë 5000 lekë për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues. Dosja individuale me dokumentet e aplikantëve jofitues u kthehet atyre kundrejt kërkesës në dorë ose me postë.

15. Studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë programe studimi të ciklit të tretë, nuk janë të detyruar të grumbullojnë 60 kreditet e studimeve të organizuara teorike, pjesë e programit të studimit të doktoraturës, vetëm nëse programi i studimit të cilin ata kanë përfunduar apo vijojnë ka formim teorik të njëjtë ose të afërt me atë të programit të doktoratës.

Këshilli i profesorëve ngre komisionet e drejtuara nga kordinatori i programit të doktoratës për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë në varësi të përputhshmërisë së tyre me programin e studimit të doktoratës ku ai është regjistruar. Për çdo student të tillë përcaktohen veprimtaritë formuese, modulet lëndore dhe kreditet përkatëse, të cilat ai është i detyruar t'i fitojë nga plani i studimeve të organizuara të programit të studimit përkatës të doktoratës.

16. Tarifa e shkollimit për një program doktorate është e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ku brenda vlerës së përcaktuar paraqet:

a)vlerën për pjesën e studimeve të organizuara, e cila ndahet për çdo modul lëndor në varësi të krediteve që i takojnë atij;

b) vlerën për pjesën e studimeve për periudhën që përmbledh kërkimin shkencor dhe përgatitjen e disertacionit deri në marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor".

17. Tarifa e shkollimit paguhet nga studenti në këste të përcaktuara nga njësia kryesore e institucionit të arsimit të lartë përgjegjës për organizimin e doktoratës. Kësti i parë paguhet menjëherë me regjistrimin e studentit dhe është sa vlera e tarifës për pjesën e studimeve të organizuara. Studentët që kanë transferuar kredite nga programe të tjera të ciklit të tretë paguajnë vlerën përkatëse sipas moduleve lëndore dhe krediteve që ata duhet të fitojnë në programin përkatës të doktoratës.

18. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë të cilat organizojnë studime të doktoratës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja

VENDIM
Nr.58, datë 7.8.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË BALKAN GREEN ENERGY "SHPK ME SERI PV03K, NR.3, LËSHUAR ME VENDIM TE BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.20, DATË 19.12.2003

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të "licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet ekzistues, me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW", si dhe nenet 10 dhe 15 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve,Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Balkan Green Energy" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.3, seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga "Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave"

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licensës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtura nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.59, datë 19.8.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN NE AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "TEODORI 2003 " SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa "a", 9 dhe 13 pika 1, germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për proçedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa a, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "TEODORI 2003" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

- Paraqitjen e aplikimit konform përcaktimeve të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave",

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "TEODORI 2003" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.60, datë 19.8.2009

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARKU EOLIK MASKURI) TË SHOQËRISË "RUNNING ENERGY" SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të çertifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", neni 9, pika 1 dhe pika 2, germa "a", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "RUNNING ENERGY" për kualifikimin e impianteve prodhuese (parku eolik Maskuri) si burime te rinovueshme energjie

konstatoi se:

- Me vendimin nr.48, datë 6.7.2009, Bordi i Komisionereve ka filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "RUNNING ENERGY" për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime të rinovueshme energjie.

- Dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit është në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 7, pikat 1, 2 dhe 3 të rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik Maskuri) të shoqërisë "RUNNING ENERGY " si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.61, datë 19.8.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PURO ENERGY STEBLEVA" SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 "a", neni 9 dhe 13 pika 1, germa "a", neni 18 pika 1 germa "d" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a", dhe 13, 14 të rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "PURO ENERGY STEBLEVA" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionin finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4);
- Lejet nga institucione të tjera (leja mjedisore dhe leja e përdorimit të ujit) (neni 9, pika 4.1.5, germa "b" dhe "c")

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Plotësimin në mënyrë të pjesshme të lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, germa "a", pasi për arsye të privatizimit dhe riorganizimit të shoqërisë OSSH sh.a., aplikuesi nuk ka mundur të paraqesë një dokument final nga OSSH sh.a. (është paraqitur vetëm nga drejtoria rajonale TL Elbasan)

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Stebleva me fuqi 3.4 MW me kusht që të paraqesë dokumentin e miratimit të pikës së lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit të operimit të HEC Stebleva.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. "PURE ENERGY STEBLEVA" shpk ta fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Stebleva sipas afatit te përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

6262

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr.6231, datë 10.7.2009 vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Hajdar Kasa.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 10.9.2009
Doli nga shtypi më 11.9.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 20 lekë